



Thirrje për aplikim për Kërkimin Operacional në Shëndetësi

1. KONTEKSTI

Shëndet për të Gjithë është një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale në Bazel, në bashkëpunim me Qendrën HAP në Shqipëri. Qëllimi kryesor i projektit është të mundësojë që popullsia shqiptare të gëzojë shëndet të mirë falë shërbimeve të përmirësuara të kujdesit shëndetësor parësor. Pritet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe njësitë e saj rajonale të përmirësojnë mbikëqyrjen, menaxhimin dhe efikasitetin e kujdesit shëndetësor parësor, dhe që qytetarët në qarqet e synuara të kenë akses dhe t'i përdorin me efikasitet shërbimet cilësore të kujdesit shëndetësor parësor. HAP-i po mbështet Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në hartimin e Strategjisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor (KSHP), si një element të forcimit dhe përmirësimit të sistemit shëndetësor në Shqipëri. Krahas kësaj, për fazën e saj të zbatimit janë parashikuar shumë ndërhyrje të tjera lidhur me burimet njerëzore në shëndetësi dhe menaxhimin e tyre, prezantimin e qasjeve të reja të zgjerimit të shërbimeve të KSHP-së në kuadër të mbulimit universal, si kujdesi në shtëpi për pacientët me Sëmundje jo të transmetueshme (SJT) dhe zgjerimi i rolit të infermieres, forcimin e kapaciteteve menaxheriale të menaxherëve shëndetësorë në KSHP dhe më gjerë, forcimin e rolit të infermierëve dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre profesionale, etj.

Shqipëria ka mungesë evidencash në fushën e KSHP-së dhe të Shëndetit Publik, gjë që krijon një hendek ndërmjet proceseve të politikëbërjes e planifikimit dhe operacioneve/veprimeve që duhen ndërmarrë për të sjellë përfitime shëndetësore. Për më tepër, gjetjet dhe rezultatet e kërkimit operacional, që është kryer deri më tani, nuk janë përkthyer sistematikisht në politika dhe dokumente strategjike nga ana e vendimmarrësve. Gjithçka që është përmendur më sipër tregon për mungesën e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore për të kryer kërkim operacional, si dhe për financimin dhe përkthimin e pamjaftueshëm të këtyre rezultateve në politika dhe strategji.

Në këtë kontekst, HAP-i synon të forcojë dhe përmirësojë organizimin dhe shërbimet e KSHP-së në Shqipëri, nëpërmjet mbështetjes për kërkimin operacional në sistemin dhe shërbimet shëndetësore, dhe forcimit të kapaciteteve të kërkuesve të rinj. Për të arritur objektivin e sipërpërmendur, HAP-i do të kryejë një sërë ndërhyrjesh, si: 1) prezantimi i një iniciative financuese për të mbështetur aktivitetet e kërkimit operacional; 2) zbatimin e iniciativës me qëllim gjenerimin e të dhënave të bazuara në evidenca lidhur me sistemin dhe shërbimet shëndetësore, dhe ndikimin e projektit; 3) mbështetja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucioneve të saj të varësisë për t'i përkthyer të dhënat dhe gjetjet e kërkimit në politika dhe strategji. Paralelisht me këtë, HAP-i do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të kërkimit operacional në vend, nëpërmjet trajnimit të kërkuesve të rinj.

2. Objektivi i kësaj thirrjeje

Objektivat e kësaj thirrjeje janë:

- të sigurojë mundësi financimi për kryerjen e kërkimit operacional në aspekte të ndryshme të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri, me fokus në kujdesin shëndetësor parësor (KSHP) dhe në shëndetin publik (SHP), dhe
- të mbështesë kapacitetet kërkimore të kërkuesve të rinj në vend, nëpërmjet trajnimit dhe mundësisë për zbatimin e aktiviteteve të kërkimit operacional.



3. Fushat e sugjeruara për kërkime operacionale

Më poshtë paraqitet një listë e fushave të sugjeruara të KSHP-së dhe SHP-së, që duhen eksploruar nëpërmjet zbatimit të kërkimit operacional. Megjithatë, aplikantët ftohen që të propozojnë çështje të tjera, por të lidhura ngushtë me Kujdesin Shëndetësor Parësor dhe Shëndetin Publik. **Shënim: kjo thirrje për aplikim mbështet vetëm kërkimin operacional dhe jo kërkimin mbi çështje klinike, pasi këto të fundit nuk pranohen për këtë thirrje.**

Fushat e pranueshme të kërkimit mund të jenë:

- Eksplorimi i çështjeve të Burimeve Njerëzore në Shëndetësi (BNJSH) - në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor dhe në nivele të tjera (edukimi, shpërndarja, produktiviteti dhe motivimi, rolet dhe përgjegjësitë, etj.). Një temë ideale e veçantë e kërkimit do të ishte roli i infermierëve në sistemin shëndetësor aktual dhe të ardhshëm të Shqipërisë.
- Eksplorimi i sëmundjeve jo të transmetueshme si një problematikë e shëndetit publik (diabeti, hipertensioni, sëmundjet kardiovaskulare, etj.).
- Eksplorimi i lidhjeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Shëndetit Publik.
- Eksplorimi i çështjeve të cilësisë së kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri.
- Eksplorimi i çështjeve të sistemit të informacionit shëndetësor në kujdesin shëndetësor parësor dhe më gjerë.
- Eksplorimi i nevojës për shërbimet alternative në kujdesin shëndetësor parësor - koordinim me shërbimet e tjera, për shembull shërbimet sociale, shërbimet në shtëpi, kujdesi paliativ, shërbimet rehabilituese, etj.
- Eksplorimi i çështjeve lidhur me menaxhimin e kujdesit shëndetësor parësor.
- Edhe çështjet e tjera lidhur me shëndetin dhe sistemin në kujdesin shëndetësor parësor janë të pranueshme.

Temat transversale, si **aspektet gjinore** dhe **parimet e qeverisjes së mirë**, kanë rëndësi të madhe për HAP-in, ndaj edhe aplikantët nxiten shumë që t'i përfshijnë këto tema/çështje në projektet e tyre kërkimore.

4. Aspektet organizative të skemës

Iniciativa e “Mikrofinancimit për Kërkimin Operacional në Sistemin dhe Shërbimet Shëndetësore” do të organizohet dhe menaxhohet nën drejtimin e HAP-it. **Aspektet teknike të kësaj iniciative do të detajohen dhe përcaktohen nga një Bord Këshillimor Kërkimor (BKK).**

4.1 Përbërja e Bordit Këshillimor Kërkimor

Bordi Këshillimor Kërkimor (BKK) përbëhet nga kërkues me përvojë në shëndetin publik dhe në menaxhimin e shërbimit shëndetësor. Ata janë edhe përfaqësues të instituteve dhe organeve kërkimore, dhe institucioneve (akademike) të arsimit të lartë. Qëllimi kryesor i BKK-së është të këshillojë dhe mbështesë HAP-in për zbatimin e iniciativës.

Sekretaria e BKK-së do të koordinojë procesin e aplikimit, menaxhimin e thirrjes dhe çështje të tjera logjistike. Sekretaria mund të kontaktohet nëpërmjet një adrese të dedikuar, operational.research@hap.org.al dhe të gjitha komunikimet lidhur me mikrofondet për kërkimin operacional do të bëhen përmes këtij kanali komunikimi.

4.2 Afati kohor për projektet e kërkimit operacional

Aktivitetet e kërkimit operacional do të zbatohen përgjatë një viti kalendarik, janar 2020 – janar 2021.



4.3 Projektet e mbështetura kërkimore

Propozimet kërkimore më të mira do të mbështeten në përputhje me buxhetin e lëvruar. Aplikantët e suksesshëm do të mbështeten përmes aktiviteteve trajnuese që do të kryhen në Shqipëri për aspekte të ndryshme të kërkimit operacional.

4.4 Shuma e fondeve

Iniciativa e mikrofinancimit do të mbështesë propozimet kërkimore me shumën deri në 3,000 CHF. Lëvrimi i fondeve do të bëhet pas dorëzimit të produkteve specifike, siç shpjegohet në **Pjesën 7** të kësaj thirrje.

Aplikanti duhet të dorëzojë një format buxheti, në të cilin të shpjegojë se si do të shpenzohet ky fond, në përputhje me zërat e buxhetit të renditura. **Shpenzimet jo të pranueshme** lidhur me këtë thirrje janë:

1. Pagesë për mentorët të përfshirë në zbatimin e studimit;
2. Blerje e pajisjeve IT ose pajisjeve të disponueshme nëpërmjet institucionit të aplikantit (p.sh., softëare/aksesor kompjuteri, projektor, printer, etj.);
3. Pagesë për përgatitjen e projektit kërkimor për aplikantin e kërkimit ose për persona të tjerë që asistojnë aplikantin e kërkimit;
4. Shpenzime për aktivitete të shkuara tashmë të përfunduara;
5. Shpenzime që nuk lidhen me zbatimin e projektit kërkimor.

Aplikanti mund të hartojë një buxhet me shpenzime të pranueshme, duke shpjeguar dhe arsyetuar shpenzimet. Buxheti mund të hartohet sipas nevojave kërkimore.

5. Aplikantët për kërkimin

Për të qenë të pranueshëm për të marrë një grant, aplikantët dhe projekti i tyre kërkimor i propozuar duhet të përmbushin të GJITHA kërkesat e renditura më poshtë:

Kandidati i pranueshëm:

Një kandidat i pranueshëm duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Të jetë qytetar shqiptar
- Kufiri maksimal i moshës 35 vjeç
- Minimalisht të ketë mbaruar studimet bachelor ose master në fushën e interesit
- Të jetë kërkues/shkencëtar ose profesionist që shërben në një institucion akademik publik, dhe/ose në shërbimin shëndetësor publik. Aplikantët që punojnë në organizata private, të cilët do të propozojnë punë kërkimore me fokus dhe interes për shërbimet publike, nuk do të përjashtohen.

Projekti kërkimor i pranueshëm:

Një projekt kërkimor i propozuar duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:



- Propozim kërkimor shkencor që kontribuon për njohje më të mirë të sistemit dhe shërbimeve shëndetësore shqiptare, me fokus në kujdesin shëndetësor parësor, BNJSH-në, shëndetin publik dhe fusha të tjera, siç përmenden më herët;
- Metodologji e shëndoshë kërkimore e realizueshme në terma kohorë dhe financiare;
- Kërkimi të kryhet në Shqipëri.

Mentorimi

Procesi i mentorimit do të udhëhiqet nga një mentor në fushën e akademisë (institucioneve arsimore Universitare), organizata ku i mentoruari kryen kërkimin, ose dikush me interes të madh në fushën e propozuar. Procesi i mentorimit do të organizohet nga mentori dhe i mentoruari. BKK-ja do të informohet për procesin e mentorimit dhe ecurinë e kërkimit për çdo aplikant të suksesshëm.

Mentori duhet përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Të jetë staf akademik, me përvojë në kërkim, ose
- Shkencëtar i atashuar pranë një instituti kërkimor me diplomë akademike, si PHD (preferohet), ose të paktën diplomë Masteri Shkencor në Shëndet Publik
- Ekspert në fushën lëndore të propozuar nga aplikanti për kërkim (në këtë rast, preferohet bashkëmentorimi)
- Të ketë repertor botimesh
- Preferohet të ketë përvojë në mentorim

6. Procesi dhe kriteret e vlerësimit:

HAP-i do të udhëheqë procesin e përzgjedhjes me mbështetjen e BKK-së. BKK-ja do të kryejë procesin e përzgjedhjes, aktivitetet e mbikëqyrjes së kërkimit, si dhe koordinimin për zhvillimin e kurrikulës dhe zbatimin e aktiviteteve trajnuese lidhur me kërkimin. Bordi do të vlerësojë aplikimet e dorëzuara brenda një muaji pas dorëzimit. Vlerësimi i propozime kërkimore do të kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- Propozimin kërkimor (protokollin e studimit) të studimit – deri në 40 pikë
- Planin e punës dhe afatin kohor me aktivitetet specifike – deri në 30 pikë (Plani i punës i aktiviteteve të projektit është pjesë e formularit të aplikimit)
- CV-në e aplikantit për kërkim dhe një lëterë motivimi, duke renditur përvojat e mëparshme, angazhimin në aktivitete kërkimore dhe trajnime mbi çështje kërkimore, nëse ka, dhe shpjeguar motivin për aplikim në këtë thirrje – deri në 10 pikë
- CV-në e mentorit(ëve) – deri në 20 pikë

7. Rezultatet e pritshme nga skema e mikrofinancimit:

HAP-i pret nga përfituesit e këtyre mikrofondeve që të koordinojnë dhe të kryejnë aktivitetet kërkimore, në kuadër të forcimit dhe përmirësimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe shëndetit publik. Në të njëjtën kohë, pritet që kandidati të ndjekë dhe të sjellë produkte lidhur me kërkimin, të cilat do të sigurojnë cilësinë e procesit kërkimor.

Aplikanti për kërkimin është përgjegjës për:



- a. **Hartimin e protokollit të studimit:** protokollin e studimit duhet të hartohet përpara zbatimit të kërkimit operacional. Protokollin e Studimit do të jetë një dokument që do të vlerësohet nga Komisioni i Etikës për Kërkimin në Shqipëri dhe BKK-ja.
- b. **Sigurimin e Pastërtisë Etike:** të gjitha aktivitetet kërkimore të mbështetura nga HAP-i do t'i nënshtrohen procesit të pastërtisë etike. Aplikanti duhet të ndjekë procesin e miratimit etik të administruar nga Komisioni Shqiptar i Etikës (KSHE). Aplikanti është përgjegjës për dhënien e miratimit.
- c. **Kryerjen e studimit** (rishikimin e literaturës, përdorimin dhe analizimin e të dhënave dytësore, mbledhjen e të dhënave parësore, etj.).
- d. **Hartimin e Raportit të Studimit:** Në fund të procesit, pritët që secili aplikant për kërkimin të dorëzojë një raport të shkruar mirë mbi procesin e studimit, analizat, gjetjet, diskutimet dhe rekomandimet.
- e. Rekomandohet gjerësisht **botimi dhe/ose shpërndarja** e gjetjeve të studimit (në formën e artikujve, pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare, dokumente të politikave, përmbledhje të politikave, etj., mënyra të komunikimit dhe shpërndarjes).

8. Çfarë, ku dhe kur të dorëzohet:

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentacionin më poshtë në gjuhën angleze:

- a. **Një propozim kërkimor që duhet t'i përmbahet pikave të paraqitura në Shtojcën 1 të kësaj thirrje,** "Formulari i Aplikimit për Propozimin Kërkimor". Në të njëjtën shtojcë renditen edhe shpjegimet për elementet e aplikimit.
- b. **Planin e punës** sipas Shtojcës 2 të kësaj thirrje.
- c. **Propozimi financiar** duhet të dorëzohet në një formular të veçantë. Shpenzimet jo të pranueshme përmenden në pjesën **4.4** të kësaj thirrje.
- d. **Një letër** nga institucioni ku do të kryhet kërkimi, duke konfirmuar interesin për këtë kërkim dhe gadishmërinë për të mbështetur zbatimin e projektit. Në Shtojcën 3 të kësaj thirrje paraqitet një format i kësaj Letre.
- e. **CV-në e aplikantit** për kërkim dhe **një letër motivimi**, duke renditur përvojat e mëparshme, angazhimin në aktivitete kërkimore dhe trajnime mbi çështje kërkimore, nëse ka, dhe shpjeguar motivin për aplikim në këtë thirrje.
- f. **CV-në e mentorit** që mbështet aplikantin gjatë gjithë procesit, nga konceptimi deri në finalizimin e projektit

Të gjitha dokumentet e sipërpërmendura duhet të dorëzohen pranë sekretarisë së mikrofondeve për kërkime operationale, në adresën operational.research@hap.org.al.

Afati përfundimtar për dorëzim është *20 Shkurt 2020, ora 16:00*. Dorëzimi me vonesë i çdo dokumenti të kërkuar nuk do të pranohet.

9. Pyetje

Nëse keni ndonjë pyetje për këtë thirrje, ju lutemi dërgojini ato me email në adresën operational.research@hap.org.al deri më 7 shkurt 2020. Pyetjeve përmes telefonit nuk do t'iu kthehet përgjigje.